



Pranimi / Dorezimi / Prilazja / Prilazja	08.12	2021	1	viti / god / year
Organ / Organizata / Organ / Organizata	Pr. Pril / Pr. Pril	Pril / Pril	Pril / Pril	Sasia / Kolicina / Quantity
SHKIPARICU	5877/2021			1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.862/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.862/2021 të datës 12.10.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: Rruga “Radovan Zogovic”, Nr.23 Blloku C, Hyrja 5, lagjja Arbëri, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Financave, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.862/2021 të datës 12.10.2021 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja në bazë të Akt emërimit të datës 16.02.2017 e punësuar në Ministrinë e Financave, në pozitën “Analiste e Lartë e Buxhetit”, ka aplikuar në konkursin e brendshëm-lëvizje paralele brenda së njëjtës kategori të datës 21.07.2021 për pozitën ‘Auditor i brendshëm’.

Me datë 07.09.2021 Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen Brenda Kategorisë në Shërbimin Civil (KVLBK) ka hartuar listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve ku ankuesja nuk ka qenë si kandidatja më e vlerësuar respektivisht kandidate fituese.

Ankuesja kundër listës përfundimtare të datës 07.09.2021 të hartuar nga Komisioni i Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Shërbimin Civil (KVLBK) ka parashtruar ankesë të brendshme me datë 09.09.2021, ndërsa Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen Brenda Kategorisë në Shërbimin Civil (KVLBK) me datë 16.09.2021 ka nxjerr vendimin numër:03/2021 dhe ka refuzuar ankesën e ankues të datës 09.09.2021 si të papabuar.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin e datës 09.09.2021 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Shërbimin Civil (KVLBK) ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 12.10.09.2021 dhe është protokolluar me numër: 4992/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datën 15.10.2021 në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses. Me datë 25.10.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Në mbështetje të nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh rrethanat e funksionimit të KPMSHCK-se, me Vendimin nr.59/2021 të datës 25.11.2021 të Kryesuesit të KPMSHCK-së është vazhduar afati për vendosje të ankesës me numër A.862/2021 të datës 12.10.2021 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore administroj këto **prova**: Ankesën me numër protokoll 4992/2021 e datës 12.10.21 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve të datës 07.09.2021; Vendimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Shërbimin Civil (KVLBK) të datës 16.09.2021; Ankesën e ankueses të parashtruar brenda institucionit e datës 09.09.2021; E-mailin e datës 06.10.2021 i dërguar nga ankuesja për Sekretarin e Përgjithshëm me korrespondencën e bashkëngjitur prej 3 faqesh; Konkursin e datës 21.07.2021; Njoftimin për listën e ngushtë të datës 19.08.2021; E-mailin e datës 08.09.2021 nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin me prezantimin e rezultatit final; E-mailin e datës 19.08.2021 nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin me ftesën për intervistim; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.10.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 25.10.2021; Diplomën me numër 2445 të datës 02.03.2011; Diplomën e datës 07.07.1992 me numër prot:233; Çertifikatën e datës 22.09.2020 me numër:286/2020; Vendimin e Kryetares së Kuvendit të Kosovës të datës 10.07.2021 në dy gjuhët zyrtare; Vendimin e Kryeministrit të Kosovës të datës 02.04.2019; Akt emërimit të kandidatit të datës 05.09.2012; ndryshimin dhe Plotësimin e akt emërimit të datës 20.01.2015; Fletë referencën e datës 25.05.2006; vërtetimin e datës 16.12.2019; letër referencën e lëshuar nga BZMF për Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 14.01.2021 Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 27.12.2019; Vërtetimin e datës 09.08.2021 lëshuar për Çertifikatën e lëshuar nga IKAP për Çertifikatën e lëshuar nga FLSA për Çertifikatën e lëshuar nga E&E Consulting për Çertifikatën e lëshuar nga FLSA për e vitit 2017; Çertifikatën e lëshuar nga Akademia për Siguri Publike për Arben Dodaj; Çertifikatën e datës 20.01.2021 e lëshuar nga Ministria e Financave për Çertifikatën e falënderimit të lëshuar nga FLSA për Çertifikatën e lëshuar nga Raiffaisen Bank Kosovo për e datës 04.04.2008; Çertifikatën e lëshuar nga ICCED për Çertifikatën e lëshuar nga OSCE për Çertifikatën e datës 10.12.2004 të lëshuar për Dokumentacionin e kompletuar të kandidatit Dokumentacionin e kompletuar të kandidatit Diplomën e ankues me numër 486 të datës 20.03.2003; Çertifikatën e datës 05.06.2019 lëshuar për ankuesen; Çertifikatën e lëshuar nga IPVQ për ankuesen; Çertifikatën e lëshuar për ankuesen e datës 29.05.2020; Vendimin e datës 29.07.2016; Shkresë-dëshmi për masë disiplinore e datës 29.07.2021; Vërtetimin e datës 09.08.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës e datës 22.01.2021 për ankuesen ; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës e datës 26.12.2019 për ankuesen; Dokumentacionin e kompletuar të kandidatit Dokumentacionin e kompletuar të kandidatit Akt emërimit të kandidatit Akt emërimit të kandidatit Listën e ngushtë të kandidatëve të datës 19.08.2021; Vendimi për pezullimin e marrëdhënies së punës i datës 13.08.2021; Vendimin për themelimin e komisionit KVLBK të datës 18.08.2021; Akt emërimit e Diplomën e Akt emërimit Diplomën e Akt emërimit e



Diplomën e Akt emërimin e Formularin e renditjes
përfundimtare të kandidatëve të datës 07.09.2021; Njoftimin për kandidatin fitues i datës 08.09.2021; Përgjigje
e datës 29.10.2021 përmes emaili dërguar nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve njerëzore të Ministrisë së
Financave, Punës dhe Transfereve e protokolluar në Këshill me nr:52.09/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vendosur të bëjë
përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankueses **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se në konkursin me
nr.Ref.RN00007311 për "Lëvizje Brenda Kategorisë" të shpallur me datë 21.07.2021 për pozitën "Auditor i
Brendshëm" ka aplikuar edhe kandidatja e cila me datë 22.10.2021 ka pashtuar ankesë në
KPSHCK me numër A.nr.883/2021 të datës 22.10.2021, duke kundërshtuar përzgjedhjen e kandidatit fitues për
ketë pozitë. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me rastin e vendosjes së ankesës se
së ankueses me Vendimin A.nr.883/2021 të datës 02.12.2021 ka anuluar procedurën e "Lëvizje
Brenda kategorisë" me Nr.ref.RP00007311 për pozitën "Auditor i Brendshëm" i shpallur nga Ministria e
Financave, Punës dhe Transfereve si dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me këtë procedurë të rekrutimit. Andaj,
bazuar në këtë konstatim si dhe në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme
Administrative, i cili përcakton se: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik
kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i
kotë*", Kolegji ka vendosur që të përfundoj procedimi administrativ i incizuar me ankesën me numër
A.nr.862/2021 të datës 12.10.2021, pasi që objekti i ankesës është bërë i pamundur apo i kotë.

Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1
nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur
Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk
është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për
Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.
Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.862/2021

Flakron GASHI


Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave dhe Arkivit të KPMSHCK- së.

